

VENDIM
Nr. 14, datë 23.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“HEC BISHNICA 1, 2” SHPK, NR. 95, SERIA PV10K, DHËNË ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 23, DATË 23.3.2010, PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 9, pika 1, germa: “a”, “b” dhe “c”; nenit 10, pika 1 dhe 3; nenit 15, pika 1, 2, germa “b”, dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 8 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 19/1 prot., datë 18.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., për modifikim licence në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 95, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga “HEC Bishnica 2”, me fuqi të instaluar 2.5 mw, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për një afat 30-vjeçar.

- Kjo shoqëri, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 738, datë 13.11.2019, “Kërkesë për modifikim licence për shtesë fuqie”, deklaron se ka marrë miratimet nga MIE dhe AKBN-ja dhe ka vijuar me instalimin e një agregati të ri, me fuqi 1460 kv.

- ERE, më datë 13.12.2019, zhvilloi një seancë dëgjimore mes përfaqësuesve të ERE-s dhe përfaqësuesve të shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2”. Në këtë seancë ishin ftuar të merrnin pjesë dhe përfaqësuesit e AKBN-së dhe MIE-s, për të shprehur qëndrimin e tyre në lidhje me sa miratuar dhe në lidhje me sa pretenduar nga ana e shoqërisë. Përfaqësuesit e AKBN-së dhe MIE-s nuk u paraqitën në takim.

- Shoqëria bëri me dije se vendosja në punë e të tre aggregateve do të bëhet vetëm me qëllim prodhimin e energjisë së përcaktuar në kushtet kontraktuale dhe vetëm në periudha të caktuara kohore, në varësi të reshjeve.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), pa plotësuar;
- germa “b” (të dhënat identifikuese për aplikuesin), pa plotësuar;
- germa “c” (të dhënat për aplikuesin), pa plotësuar.

*Aplikanti nuk ka plotësuar formatin e aplikimit, por shkresa e tij e protokolluar në ERE me nr. 738, datë 13.11.2019, “Kërkesë për modifikim licence për shtesë fuqie”, përmban të dhëna të cilat shërbejnë për identifikimin e subjektit të licencuar.

Neni 15, pika 4:

- germa “a” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës), plotësuar. Shoqëria ka deklaruar se kërkesa për modifikim të licencës vjen si rezultat i

vendosjes së një agregati të ri prej 1740 kW dhe shtesës së fuqisë nga 2.4, në 4 mw, të instaluar, pasi ka marrë miratimet përkatëse nga MIE dhe AKBN-ja. Nga sa vlerësuar, referuar dhe dokumentacionit të depozituar për qëllim të këtij aplikimi, miratimet janë bërë në kushtet e optimizimit të skemës dhe jo të rritjes së fuqisë/kapacitetit të instaluar;

- germa “b” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës), pa plotësuar;

- germa “c” (miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera), plotësuar;

- germa “d” (ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi), plotësuar;

- germa “e” (të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE), plotësuar.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti, që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e aneksit të licencës nr. 95, seria PV10K, të shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, me ndryshimin si më poshtë:

Numri i njësive gjeneruese:

është: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw,

bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti